



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Prezantimi nga ministri për Financat dhe Ekonominë i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”
3. Relativim
4. Pyetje përgjigje
5. Diskutimi në parim
6. Projektligji “Për ratifikimin e korrigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Reme Lala, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Agron Shehaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike

Mungon:

Dashamir Shehi

Të ftuar:

Erjon Luci – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci (Bako) – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Në rendin e ditës së punës së këtij komisioni janë dy çështje, prezantimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Së dyti, ka edhe një çështje tjetër, e cila lidhet me projektligjin “Për ratifikimin e korrigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Për të prezantuar projektligjet, në komisionin kemi të ftuar zotin Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Relator i komisionit lidhur me të dyja projektligjet është zoti Ervin Bushati.

Do të procedojmë me prezantimin e projektligjeve nga ana e zëvendësministrit dhe pastaj me relatorin, pyetje-përgjigje dhe diskutime, në rast se do të ketë.

Po urdhëroni, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Dje në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave ngritëm disa pyetje shumë të rëndësishme lidhur me aferën e Teatrit Kombëtar dhe nuk patëm përgjigje, megjithëse ministri i Financave është përgjegjës dhe është ministër i fushës. Është një nga ministratë propozuese të këtij projektligji.

I ngritëm këto pyetje në të gjitha komisionet parlamentare, ku ministrja e Kulturës ishte prezent dhe përsëri nuk patëm përgjigje. Sigurisht, e kuptoj që qeveria dhe të gjithë deputetët këtu janë thjesht fasadë për të mbrojtur një aferë të madhe korruptive.

E kuptoj që nuk ka fjalë për të shpjeguar sesi mund të grabitet prona publike dhe t'i falet një kompanie private; e kuptoj që askush nuk mund të na japë përgjigje sesi është e mundur që një kompani pa tender, pa garë të bëjë një propozim nga asgjëja dhe i gjithë shteti të ngrihet në këmbë.

Kushdo që e ka lexuar projektligjin dhe relacionin e tij e kupton se prej datës 22 shkurt deri në fund të marsit, kur është bërë gati projekti i firmës, e gjithë qeveria është ngritur në

këmbë. Çdo dy ditë ka përgjigje shkresash; çdo dy ditë ka komunikim me institucionet; çdo dy ditë ka informacion që shkëmbehet.

Ndërkohë që gjatë 9 muajve deputetëve të këtij parlamenti nuk u jepet asnjë informacion për tenderat dhe koncesionet, ministritë kthejnë përgjigje brenda ditës për aferën korruptive. Në fakt, ngjan shumë me aferën korruptive të inceneratorëve, ku për një muaj, i gjithë shteti kthente përgjigje brenda ditës dhe po brenda ditës negocionin kontratën.

Na kanë sjellë në parlament një projektligj, i cili është antikushtetues dhe shkel të paktën tri ligje të tjera; na kanë sjellë një projektligj, i cili cenon rëndë pavarësinë e pushtetit vendor, sepse bën transferimin e pronës pa vendim të këshillit bashkiak; sepse autorizon kryetarin e bashkisë të lidhë një kontratë me një kompani në mënyrë korruptive; sepse autorizon një komision për të negociuar një kontratë, e cila fal dhe grabit pronën publike.

Në 5 vjet ne kemi dëgjuar për shumë afera, kemi dëgjuar për *chek up*-in, për sterilizimin, për inceneratorët, për aeroportin e Vlorës, por asgjë nuk ka krahasim me aferën e Teatrit Kombëtar. Kemi ndjekur me interes të gjitha diskutimet që janë zhvilluar në komisionet parlamentare dhe ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje se përse shkelet ligji i koncesioneve, pse nuk bëhet një tender ndërkombëtar dhe përse falet prona.

Dje dëgjuam me interes edhe ministren e Kulturës duke shpresuar se do të na jepte informacion përse në 5 vjet Teatri Kombëtar nuk ka pasur mundësi të restaurohet me fondet e buxhetit të shtetit. E dëgjuam me interes kur tha se ka mbledhur fonde nga donatorë, se ka pasur shumë projekte në këtë fushë, por vetëm Teatri Kombëtar nuk është prekur. Fondi në dispozicion për Teatrin Kombëtar është përdorur për vepra të tjera duke treguar që strategjia për të prishur Teatrin Kombëtar, për ta shkelur pronën publike, për ta falur atë dhe për ta grabitur nuk ishte e këtij viti, as e këtyre dy muajve, por kishte kohë që zhvillohej në mendjen e qeverisë.

Kam ndjekur me interes edhe të gjitha argumentet që kanë dhënë aktorët. Në fakt, kjo nuk është një çështje që u përket vetëm atyre, por është një çështje qytetare për të cilën ka folur i madh e i vogël, por ende nuk kemi dëgjuar të flasin, të paktën me argumente serioze, ata që duhet të ishin përgjegjës e që duhet të jepnin përgjigje për këtë çështje.

Pse ka fonde për të restauruar qendrat e qyteteve, 500 milionë euro, dhe nuk gjenden 30 milionë euro për Teatrin Kombëtar? Pse ka fonde për luksin e ministrive? Pse ka fonde për blerjen e automjeteve mbi 100 milionë euro dhe nuk gjenden 30 milionë euro për Teatrin Kombëtar? Pse po përpiqen që të zhdukin identitetin e qytetit të Tiranës, të prishin çdo godinë,

çdo ndërtesë dhe ta kthejnë këtë qytet në një qytet pa histori? Si ka mundësi që vjedhja dhe korrupsioni të na i mbyllë sytë kaq shumë sa që të mos shohim të vërtetën, që Teatri Kombëtar nuk është thjesht një godinë e vjetër, por është një godinë që mbart histori.

Këtu në Komisionin e Ekonomisë kemi ngritur shqetësimin për pastrimin e parave të krimit dhe të drogës; kemi ngritur shqetësimin e korrupsionit galopant, 3.2 miliardë euro ka shkuar dëmi ekonomik i deklaruar nga KLSH-ja; kemi ngritur shqetësimin për aferat korruptive për tenderat dhe faktin që çdo tender këtu merret nga 11 persona; kemi ngritur shqetësimin se një në tri tendera është pa garë dhe jepet pa konkurrim dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë; së fundi, kemi ngritur shqetësimin se paratë e drogës po depërtojnë në ekonomi. Afera e Teatrit Kombëtar është shembulli më i mirë sesi do të pastrohen paratë e krimit dhe të drogës.

Ndërtimi në qytetin e Tiranës ka pasur një bum në dy vjetët e fundit: janë dhënë 231 leje ndërtimi të pashpjegueshme për kapitalin që ato kërkojnë. Të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë pak ditë më parë tregojnë se kredia për biznesin përsëri ka rënë, ndërkohë që bizneset përdornin fonde alternative për ta financuar ndërtimin. Fondet alternative janë ato që Departamenti i Shtetit i cilëson si para të krimit dhe të drogës, pikërisht në sektorët që po mbështeten nga qeveria, në ndërtim, hoteleri dhe turizëm.

Shpresojmë shumë që deputetë socialistë të ndershëm, me ndërgjegje të ngrenë zërin për aferën e teatrit. Ka ende kohë deri ditën e enjte; ka ende kohë sa të negociohet kontrata; ka ende kohë, sepse jam e sigurt që Presidenti do ta kthejë përsëri në parlament këtë ligj antikushtetues.

Shpresojmë shumë që në muajt në vijim të kemi edhe zëra brenda së majtës që të flasin për këtë, ashtu siç folën në vitin 2002 kur ndaluan planin e Edi Ramës për ta prishur teatrin!

Shpresojmë shumë që qytetarët e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë të bashkohen për ta mbrojtur këtë aset kombëtar!

Të mos lejojmë që Shqipëria të humbasë përsëri rastin dhe shansin për të pasur ndërtesa historike me vlerë, me identitet, për të pasur përsëri një teatër, ndoshta të vjetër, por të restauruar.

Kemi ngritur shqetësimin e datës 28 qershor për një muaj e gjysmë me radhë, kemi paralajmëruar që krimi dhe korrupsioni po e pengojnë integrimin dhe faktikisht kështu ndodhi. Faktikisht, nuk u shtynë negociatat, por u shty marrja e vendimit për hapjen e negociatave deri në fund të dhjetorit të vitit 2019. E kështu si shkojnë punët, si po degradon sistemi, si po degradon pushteti, duke se vendimi nuk do të merret as në vitin 2019.

Nuk e them me kënaqësi as unë, as kolegët e mi dhe as Partia Demokratike, se nuk është kjo që meritonë shqiptarët, por me këtë qeveri, me këto afere korruptive me krimin, me korrupsionin, e ardhmja e Shqipërisë nuk duket europiane; e ardhmja e Shqipërisë nuk duket pjesë e familjes europiane, por duket më shumë pjesë e bandave të krimit të organizuar; duket më shumë pjesë e asaj që Shqipëria ishte para vitit 2005. Ndaj, kërkojmë edhe një herë që së pari, në këtë komision të fillojmë të diskutojmë për çështjen e Teatrit Kombëtar. Zoti Luçi, fatkeqësisht ka firmosur ligjin në emër të ministrit të tij, por duhet ta firmoste ministri vetë, në qoftë se do të kishte guxim.

Së dyti, kërkojmë që, në të gjitha komisionet parlamentare, deputetët tanë, kolegët socialistë, të mos bëhen mburojë për këtë aferë korruptive, të mos bëhen mburojë për korrupsionin, por të diskutojmë bashkërisht e të dalim përtej ndasive politike se cila është më e mira për Shqipërinë, për Tiranën dhe për Teatrin Kombëtar, për këtë aset kombëtar që, fatkeqësisht, është bërë preja e radhës së korrupsionit qeverisës.

Faleminderit, zoti Braçe!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Tabaku!

Zonja Tabaku, meqë u ngritën disa çështje lidhur me punën e komisionit, do të doja të sqaroja edhe një herë shqyrtimin e projektligjit për zhvillimin e zonës rreth e qark teatrit dhe ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar.

Nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është përcaktuar që ky projektligj të shqyrtohet në Komisionin e Edukimit, në Komisionin e Ligjeve, si komision për dhënie mendimi, dhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese.

Pra, janë tri komisione të përhershme të Kuvendit, në dijeninë time, që po e shqyrtojnë këtë projektligj. Në dijeninë time, ju keni qenë prezente në të tria komisionet. Si Parti Demokratike, edhe ju ju pashë në njërin prej komisioneve, secilën prej pyetjeve që ngritët këtu, lidhur me projektligjin në fjalë, mund ta adresoni në këto komisione, ku ligji po diskutohet gjerësisht. Nuk ka asnjë pengesë për të bërë pyetje, për të marrë përgjigje dhe, natyrisht, edhe për të mbajtur qëndrim, përfshi edhe diskutimin rreth atyre problematikave që ju, në të drejtën tuaj legjitime, i ngrini si shqetësime.

Së dyti, në rast se keni probleme apo keni interes për të marrë përgjigje nga një ministër i caktuar, përfshi këtu edhe ministrin për Financat dhe Ekonominë, fare mirë, sa harxhoni dy ditë kohë në këtë komision duke xhiruar bosh, sepse këtu s'keni kujt t'i merrni përgjigje për këtë

çështje, pa asnjë lloj diskutimi, mund të kishit shkruar vetëm 5 rreshta që kërkon Rregullorja, për ta thirrur ministrin në një interpelancë urgjente në sallën e Kuvendit dhe jo ta pyesnit, por t'i punonit të njëmijënjëtat deri sa të merrnit përgjigje që kërkonte lidhur me këtë çështje.

Së treti, unë mirëpres çdo lloj diskutimi që bëhet në këtë komision, por, natyrisht, gjërat duhet të kenë logjikë dhe të jenë brenda së vërtetës. Të thuash në këtë komision që kemi shpenzuar, apo qeveria ka shpenzuar 100 milionë euro për blerje automjesh, jo vetëm që është e pavërtetë, por është një problem shumë i madh në raport me të vërtetën dhe me atë që i përcillet publikut nga kjo sallë.

Ky komision e ka të gjithë mundësinë që ta bëjë këtë verifikim vit për vit në këta 4 vjetët e fundit dhe të nxjerrë shifrën reale, por 100 milionë euro për të blerë makina qeveritare, po flas, nuk janë përdorur kurrë në këtë vend që nga viti 1991 deri në momentin që po flasim.

Së fundi, për të disatën herë dëgjoj të flitet edhe në këtë komision, por edhe jashtë tij, për bumin e ndërtimit. Më vjen mirë që iu referuat Bankës së Shqipërisë, më vjen mirë që u referoheni edhe institucioneve të tjera! Unë kam përpara një analizë të Bankës së Shqipërisë, siç kam përpara edhe raportin e fundit të INSTAT-it për rritjen ekonomike gjatë tremujorit të parë të vitit. Më vjen keq, por më duhet t'ju pohoj se, sipas të dhënave të INSTAT-it dhe Bankës së Shqipërisë, ndërtimi gjatë tremujorit të parë të vitit aktual ka kontribuar në një rritje prej 0.17% në rritjen ekonomike të vendit. Ndërkohë që aktiviteti i pasurive të paluajtshme, praktikisht, në rast se do të ndodhte, ekzaktësisht aty do të materializohej pastrimi i parave të pista, është rritur me vetëm 0.01%.

Pa asnjë lloj diskutimi, gjithsecili mund t'i konsiderojë këta numra si bum. Unë nuk i konsideroj të tillë, por i konsideroj ashtu siç janë, fare minimale dhe që nuk kanë asnjë lidhje me atë që ju pretendoni, pra me bumin e madh të ndërtimit në këtë vend, dhe pastaj për shkak të tij edhe me bumin e jashtëzakonshëm të shitjes së pasurive të paluajtshme, ku materializohen ato para që vijnë nga rrugë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, mos fol për gjëra që nuk i di!

Së fundi, kam dëgjuar disa herë pretendimin që nuk paska fond prej 30 milionë eurosh për teatrin dhe që nuk shpenzohen 30 milionë euro për teatrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, e ka thënë qeveria, por unë kam qëndrimin tim për këtë çështje.

Në rast se kjo qeveri nuk do t'i impononte Bankës së Shqipërisë të harxhonte 30 milionë euro për të blerë hotel “Dajtin”, pa asnjë lloj diskutimi teatri do të ishte bërë.

Faleminderit!

Një reagim nga zonja Tabaku dhe më pas fjala për zotin Spaho.

Jorida Tabaku – Zoti Braçe, përgjithësisht kam raport shumë të mirë me të vërtetën dhe çdo gjë që kam thënë, nuk është se kam abuzuar me fjalën siç bëjnë shumë politikanë në parlament.

Në qoftë se doni, jua vë edhe juve në dispozicion shkresën kur flitet për 100 milionë euro për makina dhe shpenzime luksi. Tender me tender, një më një.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ju ndërpreva!

Erion Braçe – Që të jemi të qartë, 100 milionë euro për shpenzime automjesh, thatë. Unë mezi po pres që ju të m'i jepni 100 milionë euro për blerje automjesh, se e dëgjuan të gjithë këtë gjë.

Jorida Tabaku – Unë nuk ju ndërpreva!

A mund ta përfundoj?

Ndërkohë që në lidhje me çështjen e lejeve të ndërtimit, më vjen mirë që qeveria paska gjetur një justifikim se ku shkojnë paratë e lejeve të ndërtimit, të sektorit “Reality State” e kështu me radhë. Sipas të dhënave të INSTAT-it, në të gjithë Shqipërinë janë dhënë gjithsej 819 leje vitin e kaluar, 83% më shumë. 231 në Tiranë, 118% më shumë. Stoku i kredisë për vitin 2017 për ndërtimin ra me 2.2%, të dhëna zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

Partia Demokratike kur flet, flet me shifra dhe nuk abuzon, sidomos me sektorin bankar. Qeveria duhet të bëjë kujdes dhe të shohë këto, ashtu siç duhet të bënte kujdes qëkur paralajmëruam për rënien e euros dhe ministri i Financave erdhi këtu e tha: “Nesër do të flas me Guvernatorin, nesër do të rritet”. Sot ndodhemi në situatën ku bizneset eksportuese janë duke falimentuar. Ne nuk abuzojmë as me shifrat dhe as me informacionet e institucioneve shqiptare, por e vërteta, si e zeza mbi të bardhë, e prodhuar nga qeveria, se ne nuk kemi zyrë paralele siç kishit ju kur ishit në opozitë, është kjo dhe shifrat janë kokëfortë.

Erion Braçe – Zonja Tabaku, edhe një herë, mezi pres që ju të më tregoni tendera me vlerë 100 milionë euro për blerje autoveturash, madje që nga viti 1991 deri në korrik të vitit

2018. Në rast se ju sillni këtu 100 milionë euro tendera për blerje makinash, atëherë unë do t'ju kërkoj shumë ndjesë! 100 milionë euro për tendera makinash nuk janë shpenzuar në 27 vjet!

Së dyti, keni të paktën një vit që flisni për lejet e ndërtimit. Praktikisht, do të fillonte të maturohej dhe më në fund do të kishte dhënë efektin te sektori. Për sa kohë që Banka e Shqipërisë vazhdon të insistojë dhe të thotë që ndërtimi është rritur vetëm me 0.17% dhe aktiviteti i pasurive të paluajtshme është rritur vetëm me 0.01%, unë ju ftoj t'i numëroni lejet nga njëshi deri te dyqinda, apo tek tetëqinda, por më tregoni efektin që ka dhënë në sektor. Në qoftë se e kanë dhënë këtë efekt në sektor, keq më vjen, por paratë nuk janë letra.

Edmond Spaho - Faleminderit, zoti kryetar!

Dje ishit pak i nervozuar, në mos gaboj. Mos më thoni jo.

Erion Braçe- Zoti Spaho, për fat të keq, Spanja humbi.

Edmond Spaho – Unë mendova se e kishit me kolegun tonë, por ju e paskeni pasur me Spanjën. Spanja një herë në 4 vjet vjen dhe ikën, kurse teatri po u prish nuk bëhet më.

Ju na thatë dje se nuk e kemi në rendin e ditës këtë çështje dhe prandaj nuk e diskutojmë. Futeni në rendin e ditës në Kuvend dhe jam i gatshëm të diskutojmë, sepse ministri i Financave është një nga institucionet që ka firmosur për këtë projekt, madje i ka shpëtuar vetë përgjegjësisë dhe ka lënë të tjerët të firmosin. Problemi është që ju nuk vendosni me logjikën e argumenteve dhe debatit, por vendosni me logjikën e kartonit dhe kështu e sollët këtë projektligj, megjithëse ju kërkuam të mos e sillni, sepse është bërë një herë ky debat, ky nuk është projekt i ri, është projekt i vjetër. Edi Rama ka 20 vjet që përpiqet të ndërtojë kulla në atë sipërfaqe, madje keni qenë ju në qeverisje kur e keni marrë në shqyrtim projektin dhe e keni rrëzuar, mbase edhe nën presionin e qytetarëve të Tiranës. Atëherë pse duhet ky projekt të risillet dhe të marrë të drejtën e qytetarisë të ndërtohet?

Po kështu dje na thatë se në rendin e ditës kemi çështje shumë më të rëndësishme, janë 420 milionë lekë, të cilat do t'i kalojnë komunitetit të biznesit nga ndryshimet fiskale. Këto 420 milionë lekë bëjnë 4 milionë euro sa një bagazh “Toyot”. Në fakt, me këtë projektligj që po përpiqeni të kaloni janë rreth 205 milionë euro vetëm fitim. Pra, ky projekt vetëm fitimin e ka 205 milionë euro. Po të ishte vetëm kjo që po fiton një biznes bashkë me partnerët e tij 205 milionë euro, gjysma e së keqes, por është projekt që shoqërohet me larje parash dhe efektet negative të larjes së parave në Shqipëri po i shikojmë gjerësisht. Në bazë të fenomenit të rënies së euros janë pikërisht këto aktivitete të jashtëligjshme nga të cilat kanë humbur eksportet

shqiptare, kanë humbur qytetarët shqiptarë nëpërmjet remitançave, transfertave, kanë humbur në depozita. Pse ka ndodhur kjo? Sepse kompani të tilla me suport qeveritar, me Kryeministrin më saktë, sepse është kryeministri ai që po vjedh i pari dhe më shumë nga të gjithë në projekte të tilla, si: Air Albania; projekti për ndërtimin e aeroportit të Vlorës, ose projekti i ndërtimit të stadiumit kombëtar dhe koncesione të tjera, të cilat i ka dhënë dhe i ka mjelë në harkun e 5 vjetëve që është në qeverisje.

Ne e ngremë zërin, sepse është projekt ku grabitet prona shtetërore. Teatri Kombëtar ka 8000 metra katrorë tokë në dispozicion në qendër të Tiranës. Ju po e shisni me 460 euro metrin katror, në një kohë që atje, e dimë të gjithë, privatët që blejnë tokë nga privati për të ndërtuar e blejnë me 1000-1500-2000 euro metrin katror. Atëherë pse këtij zotërisë i duhet bërë një favor i tillë dhe t'i japim pronën shtetërore badihava? Nëse është për t'u ndërtuar atje, ia shesim dikujt tjetër, me tender të shkojë çmimi 2000 euro metri katror i tokës dhe të marrim 4- fishin e shumës, pse të marrim $\frac{1}{4}$ e shumës? Pra, ne kemi të drejtë që ngremë zërin, sepse ky është një projekt korruptiv, dhe në qendër të kësaj veprimtarie korruptive është Kryeministri që ka 20 vjet që insiston ose duhet ta bëjë dhe t'i marrë ato para, ose nuk ka. Çfarë doni nga ne në këtë rast që të heshtim kur ju grabisni tokën që është pronë shtetërore? Këto janë aspektet ekonomike, por ka edhe një aspekt tjetër shumë të rëndësishëm, që ka të bëjë me identitetin e këtij qyteti, është relike historike dhe kulturore e qytetit.

Ky qytet gjatë këtyre 20 vjetëve është shkatërruar dhe një nga përgjegjësit kryesorë është Edi Rama, i cili për tri mandate me radhë ka qenë kryetar bashkie. Sot nuk kanë mbetur objekte, të cilat dëshmojnë historinë e këtij qyteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai fitonte duke vjedhur, sepse që ta dini ju zoti Bushati, sepse nuk keni qenë atëherë, ishit në Çikago, të parit ia ka vjedhur Spartak Ngjelës. Janë anuluar 60% të qendrave të votimit në vitin 2001. Ai është mjeshtër, e dimë ne si i vjedh votat. Me atë komision zgjedhor që ishte i kontrolluar tërësisht prej jush prapë u anuluan 60% e qendrave të votimit. Hapni faqet e viteve dhe shikoni si i ka fituar.

Ai kompleks godinash atje jo vetëm teatri përbëjnë rrethin italo-shqiptar “Skënderbeg”. Zoti kryetar, ti mund të mos e dish, por ai është rrethi italo-shqiptar “Skënderbeg”, i ndërtuar me projektin e bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, që fillon nga ish-bashkia dhe përfundon tek Universiteti i Tiranës.

Ju qeshni, nuk keni faj, unë nuk dua të them ndonjë fjalë që të ma interpretoni si fyerje, por duhet të jesh qytetar i hershëm i Tiranës, që të kesh ndjesi të tilla.

Erion Braçe – Zoti Spaho, unë dhe ju jemi nga fshati i Korçës.

Edmond Spaho – E keni gabim, ti mund të jesh nga ndonjë fshat, megjithëse të jesh nga fshati nuk është turp, përkundrazi kemi 60% të popullsisë nga fshati, por t'i thuash tjetrit je nga Kina kur është nga Spanja për shembull nuk është korrekte.

Kështu që prishja e këtij objekti, sikurse edhe e stadiumit kombëtar, pjesë të ansamblit të ndërtuar që në fillimet e Tiranës, është një nga veprimet për të shkatërruar historinë dhe kulturën e këtij qyteti. Jo më kot elita është ngritur dhe kundërshton prishjen e Teatrit Kombëtar. A doni të ndërtoni një teatër të ri, modern, të bukur, më të madh dhe funksional? Keni vende sa të doni, ndërtojeni, po këtë mos e prishni! I lini ato marrëzitë që detyroni arkitektët dhe inxhinierët të thonë se nuk rikonstruktohet edhe ato nuk janë të vërteta. Nuk ka godinë në botë që të mos rikonstruktohet, madje kostoja nuk është kështu, siç thoni, e papërballueshme, ka godina shumë më të vjetra se teatri i Tiranës. Deri sa rikonstruktuat teatrin e Elbasanit, që është ndërtuar në vitin 1930, pse nuk u rikonstruktua ky që është ndërtuar 10 vjet më vonë?

Veç kësaj po shkëlmi kuadrin ligjor ekzistues, po hartoni një ligj të veçantë në kushtet kur nuk ka nevojë të ketë ligj të veçantë. Pse? Ju e keni ligjin për investimet, e keni ligjin e koncesioneve, përse duhet ligj i veçantë? Ka një kleçkë që kërkon një ligj të veçantë, sepse nuk është kompetenca juaj për t'ia dhënë tokën investitorit privat. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kjo është e drejtë e pushtetit vendor. Dhe ju në pushtetin vendor të Tiranës nuk keni 2/3 e votave. Kjo ju pengon që ta çoni përpara projektin dhe ju ka detyruar të bëni akrobaci të tilla të hartoni një ligj të veçantë, ta sillni në parlament dhe të dalë parlamenti miratuesi i dhënies së tokës investitorit privat. Kjo është në kundërshtim me Kushtetutën. Ju na thoni ne që të ankohe mi. Po ku të ankohe mi ne? Nuk ka Gjykatë Kushtetuese. Jo më kot e prishët Gjykatën Kushtetuese dhe nuk e krijoni. Një nga arsyet është edhe kjo, të mos kemi mundësi që të ankohe mi për ligje, të cilat ju i nxirrni në mënyrë të jashtëligjshme, në shkelje të Kushtetutës dhe të mos kemi mundësi posaçërisht të ankohe mi për ligjin që po nxirrni për prishjen e teatrit dhe kalimin e tokës në mënyrë joligjore tek investitori privat.

Prandaj, zoti Kryetar, i kemi ngritur këto çështje në të gjitha komisionet, përfshi edhe Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, sepse Ministria e Financave është një nga aktoret e kësaj maskerade që po bëhet me Teatrin Kombëtar.

Unë do t'ju bëj thirrje edhe një herë të gjithëve ju, që nuk jeni përzier në këtë aferë, sepse jo të gjithë janë përzier, mos u sillni si ushtarë, të ngrini dorën dhe ta miratoni, por bëni si në vitin 2001 ose 2002 kur ishte Edi Rama, i cili synoi të realizojë të njëjtën gjë, por nuk ia arriti, pasi ata që kishin një fije arsye, logjikë dhe dashuri për këtë qytet, e refuzuan.

Duke u përqendruar tek teatri mos kujtoni se hoqëm dorë nga kërkesat për dorëheqjen e Fatmir Xhafajt. Pavarësisht se nuk e morët statusin, këto kërkesa vazhdojnë të mbeten. Viti do të kalojë shpejt dhe do të duhet të jepni përsëri llogari bazuar në këto kritere, këto parametra, këto kërkesa dhe të tjera, të cilat jua ka parashtruar komuniteti ndërkombëtar! Mos vazhdoni me komedinë e Kryeministrit që thotë se negociatat qenkan hapur! Negociatat as nuk janë marrë fare në shqyrtim. Ato do të rishqyrtohen në qershor të vitit 2019, sepse nuk keni realizuar asnjë kusht. Po ju them se parlamenti gjerman nuk ka votuar për këtë çështje dhe nuk ka autorizuar qeverinë të shprehet. Kjo do të thotë që ne jemi në pikën fillestare, si në vitin 2016, kur nuk u hapen negociatat, na u vunë disa kushte, të cilat nuk u plotësuan. Edhe në këtë rast në shqyrtimin që iu bënë kushteve, nuk i keni plotësuar, dhe për rrjedhojë komuniteti ndërkombëtar ju tha të shkoni edhe një herë në qershorin tjetër dhe, nëse keni bërë progres, do të shikojnë nëse i hapin negociatat ose jo. Pra, në fuqi ka mbetur ai i vitit 2016, sipas të cilit Shqipëria nuk ka marrë dritën jeshile, i është mohuar e drejta për t'u hapur negociatat dhe për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian. Kështu që duhet ta merrni me seriozitet, sepse jeni forcë në qeverisje. Mos hidhni shashka që i shtrini dorën opozitës, e cila e ka bërë përpjekjen e saj gjatë këtyre 5 vjetëve, ka insistuar në ato drejtime, të cilat sot po ju bëhen pengesë për hapjen e negociatave. Nuk na keni dëgjuar, sot duhet të paguani çmimin për keqqeverisjen e vendit gjatë këtyre 5 vjetëve, si dhe të mbani përgjegjësi ndaj qytetarëve shqiptarë. Opozita ka qenë e hapur përgjithmonë për të dhënë kontributin e saj aq sa mundet brenda rolit të saj si opozitë, por opozita nuk ka për t'u bërë pjesë asnjëherë e qeverisjes së Edi Ramës, e bashkëpunimit me krimin, dhe trafiket me korrupsionin në nivelet më të larta. Asnjëherë nuk na keni pasur dhe nuk do të na keni bashkëpunëtorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe- Zoti Bushati, mos ndërhyini!

Edmond Spaho- Pra, asnjëherë nuk na keni pasur dhe nuk do të na keni bashkëpunëtor, sado të na luteni qoftë ju, qoftë ne me ndërmjetës ndërkombëtarë.

Faleminderit!

Erion Braçe- Zoti Spaho, ju falënderoj shumë për gjithë çfarë thatë!

M'u drejtuar si kryetar i komisionit që t'i kërkoj Kuvendit të futë në rendin e punës së këtij komisioni çështjen e shqyrtimit të projektligjit për zhvillimin e zonës rreth teatrit dhe ndërtimin e teatrit të ri.

Unë nuk e kam problem këtë gjë, zoti Spaho, por më shkon për ters të bëj punën e të tjerëve. Ju që ishit pjesë e së njëjtës mbledhje që isha edhe unë, mund ta kërkonit vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, nëse nuk mbani mend se çfarë thoni në këtë komision, ky është problem tjetër, por po jua përsëris edhe një herë ishit pjesë e së njëjtës mbledhje, ku isha edhe unë, dhe nuk e ngritët këtë shqetësim që ngritët këtu. Në atë mbledhje mund ta kërkonin fare lehtësisht që ky komision ta shqyrtonte këtë çështje. Normalisht ky komision do të krijonte të gjithë mundësinë për ta shqyrtuar këtë çështje, me modesti po ju them, më mirë se në çdo komision tjetër. Nuk e bëtë. Tani mos më kërkonit mua të bëj punën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërhyjni ju lutem!

Pra, mos më kërkonit mua të bëj punën tuaj!

Së dyti, jemi 48 orë para seancës, kështu që me titullarin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mund të konsumoni edhe sot një interpelancë urgjente për t'i punuar 1001-tat dhe për t'i kërkuar përgjigje për çdo gjë.

Së treti, zoti Spaho, unë nuk i njoh në detaje numrat e asaj sipërfaqe ku ndodhet teatri, por ju dëgjova ju. Kam kërkuar me insistim që t'i kem këto shifra, si deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Këtë mund ta kishit bërë edhe ju, unë nuk i kam marrë ende përgjigjet për ato numra. Nga llogaritja që bëtë thatë që ai territor është 8 mijë metra katrorë. Tani nga ajo që po lexoj unë në media teatri i ri do të shkojë diku te 3 mijë -4 mijë metra katrorë, sipërfaqe trualli, që do të thotë në atë llogarinë e tregut që bëtë ju janë 4 mijë-5 mijë metra, unë nuk po i hyj kësaj fare, po e marr 8 mijë metra, nuk po bëj llogarinë me 1500, por me 3 mijë euro. Atëherë 8 mijë herë 3 bëjnë 24 milionë. Zoti Spaho, me llogarinë që bëtë ju, unë po ju them nuk i di shifrat, kam kërkuar shpjegime si deputet i Kuvendit për t'i pasur numrat, po ju them që 24 milionë euro me 30 milionë euro më duket se llogaria del ndryshe.

Së fundi, po të kishit marrë pjesë në këtë komision dhe po ta kishit lejuar këtë komision duhet të kishit këtu përballë për çështjen e euros edhe Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë edhe

ministrin e Financave. Por mënyra si po i trajtoni mbledhjet nëpër komisione, natyrisht nuk krijon mundësinë që këtu të vijnë njerëzit dhe të përgjigjen për një çështje të caktuar. Nisur nga shqetësimi juaj, pa asnjë lloj diskutimi, por edhe më gjerë sesa ju, kam kërkuar sqarime për këtë gjë dhe nuk janë pak, por në 6 muaj deri në fund të marsit janë 1,8 miliardë euro të hyra në mënyrë legale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe janë të paktën 220 milionë euro më shumë se i njëjti 6-mujor i një viti më parë. Po t'u referohemi më pas edhe të dhënave të Institutit të Statistikave të konfirmuara edhe nga Banka e Shqipërisë për rritjen ekonomike, rritja e fortë që ka ardhur nga sektori i energjisë për shkak të eksporteve, anormale ta themi, por në përgjigje të vetë sistemit që mbështetet te rreshjet, tregon se ka një burim tjetër, po prapë legal, përveç atyre që ju përmenda, të hyrjes së euros në Shqipëri. Pra, duke thënë këtë do të doja të kuptoja apo t'ju kujtoja që është vlerësuar leku, monedha jonë kombëtare në këtë vend, ndërkohë që shqetësimi i eksportuesve nuk ka të bëjë me atë që thoni ju, por ka të bëjë me stabilitetin e kursit të këmbimit, stabilitet, i cili prej të paktën 1 muaji pas ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë është në parametra të qëndrueshëm.

Do të vijojë...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk merr vesh nga kjo punë, ta thashë një herë. Të lutem, mos fol nga vendi!

U bë e treta apo e katërta herë, çdo gjë e ka një kufi. Unë e kuptoj që ti e merr vesh më mirë se kushdo këtë punën e euros këtu, por, të lutem, mos ndërhy!

(Diskutime pa mikrofon)

E di që ke opinionin tënd, shumë mirë, mbaje për vete, unë kam opinionin tim.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo është e thjeshtë fare, unë nuk i ndërhyra askujt, mos të më ndërhyjë njeri dhe mbaron historia.

(Diskutime pa mikrofon)

Kur e bën për herë të tretë pastaj...

Pra, edhe ky shqetësim mund të adresohet fare mirë në qoftë se do të kishit një sjellje normale në sallën e Kuvendit, do të kishit një sjellje normale këtu në komision dhe mjaft mirë mund të diskutonim për këtë çështje, por ju keni zgjedhur të mos flisni për këtë gjë. Ju keni zgjedhur të flisni apo të përktheni shqip-shqip dokumente ndërkombëtare që vetëm ju mund t'i interpretoni në atë mënyrë. Unë nuk kam dëgjuar ndonjë nga kryeministrat e vendeve të

Bashkimit European, ndonjë nga ministrat e Punëve të Jashtme të Bashkimit European, që bëjnë pjesë në Këshillin e Ministrave, që merr vendime edhe për integrimin e Shqipërisë, asnjë nga ministrat e Brendshëm të vendeve të Bashkimit European që të kërkojë dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, ndërsa ju thoni se e keni dëgjuar, shumë mirë, puna juaj, nuk ju ndërhyj në këtë pjesë. Ju mund t'i keni dëgjuar, por vetëm na tregoni se cili është dokumenti që e bën këtë gjë!

Për pjesën tjetër pastaj, unë jap i hapur, këtu jemi në Komisionin e Ekonomisë dhe mund të diskutojmë për secilin nga ligjet që ju dëshironi.

Për replikë zoti Spaho dhe më pas e keni ju fjalën.

Edmond Spaho – Unë thashë se qëndrimi ynë ishte që të mos përfshihej çështja e teatrit në rendin e ditës dhe këtë e treguam me votë. Sa kohë që ju e përfshitë, organizmat me të cilat ne mund të diskutojmë janë ato të përfshirat dhe një prej tyre është Ministria e Financave. Dje kërkuam, edhe sot po vazhdojmë të insistojmë të debatojmë për këtë çështje, sepse është mjaft e rëndësishme.

Së dyti, për tokën duhet që llogaritë t'i bëni mirë. Në qoftë se janë 5 mijë metra katrorë që do t'ia jepni privatit, shtoji edhe një 25 kate herë sa kulla do të ndërtohen, janë një 3 kulla...

(Diskutime pa mikrofon)

5 mijë metra katrorë, herë 25 kate, herë 3 kulla që do të ndërtohen te toka e Teatrit...

Erion Braçe – Të lutem shumë, shkoni bëni punën tuaj te komisionet e tjera!

Edmond Spaho – Pra, siç edhe jua thashë, në 5 mijë metra katrorë ndërtohen 3 kulla vetëm te toka e teatrit, herë 25 kate, nxirren 205 milionë euro fitim. Për sa i takon kursit të këmbimit mund ta thërrisni Guvernatorin këtu sa herë të doni, por nuk është çështje e Guvernatorit, por çështje sjelljeje nga qeveria. Nëse qeveria kanabizon të gjithë Shqipërinë, nuk ka se çfarë të bëjë Guvernatori, eurot do të hyjnë këtu, sepse është një vend i kriminalizuar ku nuk ka rregulla, nuk ka institucione që të kujdesen për këtë. Nëse qeveria sjell kokainë me levat e saj nga Amerika e Jugut, sigurisht eurot do të hyjnë këtu brenda; nëse qeveria lejon që për çdo javë të vijë një Toyota me bagazhin plot me euro, vetëm ai kishte sjellë një Toyota në javë ose më saktë një ngarkesë në javë, pra, i bie që vetëm ai mund të ketë sjellë 150 milionë euro në vit, kështu që nuk ka guvernator që t'i bëjë derman një sjelljeje të tillë kriminale dhe duam apo nuk duam, euroja do të bjerë. Për sa u përket përfitimeve, që po na thua se e kanë forcuar lekun, lëreni euron të bjerë dhe do të shikoni si do të forcohet leku dhe ku do të shkojë ekonomia.

E fundit, dhe edhe në dy raste të tjera, e keni ndërprerë mbledhjen e komisionit me sebeb se ju kanë ofenduar. Është e dyta herë që ofendoni një kolegun tonë, por nuk ju takon ju si kryetar i komisionit të flisni me këtë gjuhë, megjithatë ne nuk po e prishim mbledhjen edhe pse mund të kemi arsye, por duam të diskutojmë për këtë çështje, kjo nuk duhet të thotë se ju duhet të vazhdoni të abuzoni dhe të keni një sjellje të tillë.

Erion Braçe – Zoti Spaho, në fjalën tuaj numërova të paktën një 12 ofendime përkundrejt deputetëve të kësaj ane...

Jorida Tabaku – Tani?

Erion Braçe - Po. Nuk ju ndërhyra për asnjë sekondë, sepse jeni kryetar i grupit të opozitës dhe natyrisht thashë: vazhdo se do ta marrësh për ters siç e morët dhe.

Po ta përsëris edhe një herë, duke u nisur nga ajo që ju thatë, unë nuk kam ndër mend të bëj punën tuaj. Në qoftë se ju nuk doni që çështja të diskutohet dhe këtë nuk e kërkon në mbledhjet e përcaktuara sipas Rregullores për këtë gjë, pa asnjë lloj diskutimi do të jetë kështu, sepse nuk kam ndër mend të bëj punën tuaj, zero.

Së dyti, po jua përsëris edhe një herë tjetër, nuk kam ndër mend ta pyes ministrin e Ekonomisë, përveçse në titullin tim personal si deputet i Kuvendit, me shkresë zyrtare dhe natyrisht po pres të marr një përgjigje zyrtare, por në qoftë se ju nuk doni ta konsumoni këtë rrugë, është puna juaj. Siç edhe jua thashë mund të konsumoni rrugën tjetër, atë legjitime, interpelancë apo seancë pyetjesh urgjente apo çfarë të doni ju, që e parashikon edhe Rregullorja dhe mund t'i merrni ato përgjigje pa asnjë lloj diskutimi. Përsëri unë nuk kam ndër mend t'ju tregoj përgjigjet që marr unë nga ministri për punën tuaj, sepse nuk bëj punën tuaj, prandaj, ju lutem, bëni punën tuaj si opozitë, është shumë e thjeshtë kjo gjë.

Së treti, çështja e vlerësimit të lekut është një çështje fare mirë edhe temë e punës së këtij komisioni. Në rast se dëshironi dhe jepni shenja të rikthimit në normalitet, pa asnjë lloj diskutimi të dy zotërinjtë, përfshi Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë dhe ministrin e Ekonomisë dhe të Financave të analizojnë këtu në komision qindarkë në qindarkë çfarë eurosh kanë hyrë në territorin e Shqipërisë në rrugë të ligjshme dhe çfarë ka hyrë në rrugë të paligjshme. Po të doni, edhe autoritete të tjera të vijnë këtu dhe të përgjigjen për këtë gjë.

E fundit, do t'ju lutesha shumë që për historinë e kokainës dhe për historinë e Toyota-ve të mos bëni gabimin e kryetarit të partisë suaj. Lërin, se për fat të mirë janë përfshirë edhe institucionet ndërkombëtare në hetimin e tyre dhe bëni durim të dëgjoni se çfarë do të thonë

institucionet ndërkombëtare. Mos u dilni për zot banditëve, sepse jo për gjë, po ju bie kjo kauza e madhe e luftës kundër krimit...

(Diskutime pa mikrofon)

Qetësohu, çfarë ke?

(Diskutime pa mikrofon)

I pashë, i kisha në qeveri në Gërdec...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, qetësohu!

Çfarë ke? Kujt po ia tregon seriozitetin?

(Diskutime pa mikrofon)

Zotëri, ta thashë edhe më parë, në rast se nuk ke dëshirë të rrish në këtë komision, mund të largohesh me qejfin më të madh të mundshëm, sepse nuk je fare pjesë e këtij komisioni dhe nuk kupton absolutisht asgjë nga këto që ne jemi duke folur dhe që kanë lidhje me ekonominë e vendit...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, as unë nuk vij në komisionin ku ti je pjesë, sepse nuk marr vesh nga ajo punë. Shko atje në komisionin tënd dhe bëj çfarë të duash, je ekspert i asaj fushe dhe vazhdo merru me atë...

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Kushi e ka fjalën.

Evis Kushi – Kemi harxhuar 1 orë dhe ende nuk kemi hyrë në rendin e ditës, prandaj do të doja të bëja 2 ndërhyrje të shkurtra për procedurë.

E para, dje kishim në rendin e ditës një projektligj shumë të rëndësishëm “Për disa ndryshime në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat””, me impakt shumë të rëndësishëm në shumë biznese, me impakt shumë të rëndësishëm në sektorin e agroturizmit, me impakt shumë të rëndësishëm në sektorin e lojërave të fatit. Më erdhi shumë keq që kolegëve të maxhorancës nuk iu dha mundësia për asnjë minutë të bënim pyetje apo diskutime, pasi kishim çështje mjaft të rëndësishme për të ngritur, por nuk ia arritëm dot për shkak të mënyrës se si u zhvillua mbledhja e komisionit.

E kuptoj shumë mirë ndjeshmërinë që kanë kolegët e opozitës për çështjen e Teatrit, pasi edhe ne jemi shumë të interesuar që kjo çështje të zgjidhet sa më mirë, sa më të drejt në interes të

qytetarëve shqiptarë, por parlamenti i Shqipërisë i ka instrumentet e nevojshme për ta diskutuar këtë çështje sa të kemi nevojë dhe për t'i dalë deri në fund me të gjitha pyetjet dhe përgjigjet, siç edhe e sugjeroi kryetari i komisionit, qoftë me seanca dëgjimore, qoftë me interpelanca dhe me shumë mekanizma të tjerë.

Pra, le t'i shfrytëzojmë këto mekanizma, por jo t'i biem në qafë një projektligji tjetër, që është po aq i rëndësishëm për të diskutuar një çështje tjetër, të cilën nuk e kemi fare në rendin e ditës. Kush jeni ju që thoni se duhet të diskutojmë vetëm këtë çështje dhe projektligjet e tjera të paketës fiskale nuk duhet t'i diskutojmë? Pse nuk qenka i rëndësishëm për ju ligji për tatimin mbi të ardhurat apo ligji për TVSH-në, apo të gjitha projektligjet e tjera që kemi? Sepse ju dje ishit në komision dhe nuk e konsideruat fare këtë projektligj, i cili ka një impakt të rëndësishëm.

Ne jemi duke folur këtu për gjitha, folëm për Teatrin, për çështjen Xhafaj, për negociatat, për euron, për të gjitha dhe vetëm për atë që është në rendin e ditës nuk jemi duke folur.

Ju lutem, zoti kryetar, ky është sugjerimi im, të hyjmë në temë sa më shpejt, sepse kemi harxhuar 1 orë kohë dhe në shumë seanca të tjera na kanë kaluar projektligje dhe shumë çështje pa i diskutuar fare...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është sot hera e parë, por u bënë disa muaj që ju nuk na lejoni të diskutojmë çështjet që janë në rendin e ditës dhe që janë me interes për qytetarët, të cilat duhet të jenë me interes edhe për ju dhe për ne.

Kërkesa ime është që t'i rikthehemi edhe një herë rendit të ditës. E para.

E dyta, kjo është për ju, zoti kryetar, sepse u bënë disa seanca që ju ua jepni fjalën kolegëve të opozitës dhe neve të maxhorancës nuk na e jepni. Ju lutem, respektoni Rregulloren në mënyrë të barabartë!

Unë e kuptoj që opozita ka vetëm fjalën, por këtu në komision jemi për t'i diskutuar bashkërisht, të ngremë argumente, prandaj duhet të jeni i drejtë me të gjithë.

Faleminderit!

Erion Braçe – E kishit nga partia këtë apo...?

Faleminderit!

Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Në fakt, ne kemi qenë shumë seriozë dhe konstruktivë për 5 vjet, sa herë që është diskutuar paketa fiskale. Kemi ngritur shqetësime dhe ju kemi kërkuar edhe juve të

votoni bashkë me ne kundër rritjes së taksave, 5 miliardë euro, 60 amendamente kemi bërë, por të gjitha në koshin e plehrave kanë shkuar. Çfarë vlere ka të flasim këtu sot për fasadën e qeverisë dhe të bëhemi fasadë?

Sot ka shqetësime më të mëdha, sot sistemi është korrumpuar, sot krimi dhe droga janë futur në qeveri, i kishit kriminelët në parlament dhe sot po menaxhojnë sistemin qeveritar, po marrin peng edhe koncesionet, ndërsa ju thonë që ne të bëhemi fasadë e qeverisë!

Për 5 vjet kemi qenë konstruktivë, por në momentin kur Shqipërisë, pas 5 vjetësh, sepse i kishit premtuar në 2013-ën, i refuzohet përsëri dera e Europës dhe ndodhemi përsëri në këtë fazë, prandaj nuk ka më kompromis, nuk ka më asnjë arsye pse ne të jemi konstruktiv dhe fasadë e qeverisë.

Dje i bëmë një pyetje ministrit, a morëm ndonjë përgjigje prej tij? Kemi diskutuar prej 1 muaji e gjysmë apo 2 muajsh për nënçmimin e euros dhe tani dëgjojmë me tallje se nënçmimi i euros qenka i dobishëm për ekonominë dhe i shëndetshëm. Kur qenka i shëndetshëm, pse ndërhyri Banka e Shqipërisë? Pse Banka e Shqipërisë ndërhyri në treg për herë të parë në 27 vjet? Të mos flasim përralla këtu, por hajdeni t'i diskutojmë...

Erion Braçe – Për herë të parë në 27 vjet, ja kjo është përrallë...

Jorida Tabaku – ... se cilat janë shqetësimet serioze të shqiptarëve. Në qoftë se ka mekanizma të shëndetshëm për ligjin e teatrit, pse nuk na ndihmoni t'i përdorim, por bëheni të gjithë fasadë dhe bllok nëpër komisione, duke mbrojtur qeverinë? Cilat janë mekanizmat e shëndetshëm që mund të përdoren për Teatrin? Ne këtë kemi zërin në komisione dhe në seancë plenare.

Erion Braçe – Zonja Tabaku, Banka e Shqipërisë ka hyrë apo ka ndërhyrë në treg për të stabilizuar kursin e këmbimit. Është detyrë...

Përparim Spahiu – Çfarë ndodhi?

Erion Braçe - Çfarë ndodhi? Ti je ekspert dhe e di shumë mirë këtë pjesë...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë kam qenë gazetar i “Zërit të Popullit”, Përparim, dhe e kam për nder që kam qenë gazetar i “Zërit të Popullit”...

Përparim, më vjen keq vetëm për një gjë, që të kam pasur ty lexues, e para.

E dyta, unë e kam për nder të punoj gazetar ku të duash ti, vetëm bastexhiun nuk e bëj dot, Përparim. Me baste nuk merrem dot, është shumë e thjeshtë kjo punë.

Përparim Spahiu – Nuk e njeh sistemin anglo-sakson ti, nuk e merr vesh...

Erion Braçe – Të basteve jo. Sistemin anglo-sakson të basteve nuk e njoh dhe nuk më ka interesuar ndonjëherë.

Përparim Spahiu – Jemi rritur shumë ndryshe, por nuk dua ta kthej në personale...

Erion Braçe – Jemi aq ndryshe sa nuk ka ku të shkojë më.

Përparim Spahiu – Na njohin...

Erion Braçe – Të lutem, mos ndërhy, të mbaroj unë një herë!

(Diskutime pa mikrofon)

Natyrisht, do të flas unë...

(Diskutime pa mikrofon)

Fare, as Muhameti. Jam kryetar i komisionit, kjo nuk ka lidhje as me Krishtin dhe as me atë...

Përparim Spahiu – Në rregull, do të pres.

Erion Braçe – Po patjetër, që do të presësh.

Zonja Tabaku, edhe një herë Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në mënyrë të qartë...

(Diskutime pa mikrofon)

...patjetër kam denoncuar Gërdecin...

(Diskutime pa mikrofon)

... patjetër edhe kryeredaktor, Edmond, pa asnjë lloj problemi, vetëm se te fshati juaj lexonin gazetën që bëja unë dhe jo tënden...

(Diskutime pa mikrofon)

Me thënë të drejtën eksperiencë bastesh nuk kam...

Përparim Spahiu – Unë nuk jam ajo drejtoresha e Tatimeve, që kam ardhur të marr më shumë lekë këtu, se merrja edhe te banka, por këtë historinë e basteve e diskutojmë në vend tjetër...

Erion Braçe – Si ishte kjo se nuk e kuptova?

Përparim Spahiu – Nuk jam drejtoresha e Tatimeve që ka punuar në bankë amerikane, sepse e njoh mirë edhe atë, e cila ka ikur nga një bankë me pagë të mirë për të kontribuar për popullin. Unë nuk jam i atillë.

Ti këtë sistemin anglo-sakson...

Erion Braçe – Ishte edhe ajo bastexhie?

Përparim Spahiu – Për historinë e basteve dhe çështjet personale me mua të kesh kujdes, kaq po të them, sepse siç të thashë jemi rritur ndryshe...

Erion Braçe – Zoti Spahiu, mos ndërhy fare, fjalën do ta marrësh vetëm kur të të vijë radha.

(Diskutime pa mikrofon)

E merr ti, po nuk ka më mbledhje, kaq e thjeshtë është.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë mund të tregoj çfarëdolloj gjëje, siç e kërkon ashtu e merr pas.

Jorida Tabaku – Zoti Braçe, më falni, debatet personale...

Erion Braçe – Dil përjashta për fyerje!

Përparim Spahiu – Nuk më ke sjellë ti këtu mua, kokrra e plehrës, i degjeneruar. A e di se kush më ka sjellë apo jo? Është hera e dytë që vij këtu unë.

Erion Braçe – Kush të ka sjellë?

Përparim Spahiu – Më ka sjellë populli fukara i Bulqizës dhe im atë që ka punuar 30 vjet atje. Kokrra e legenit! Maskara!

Nëna ime që ka punuar 35 vjet në shërbim, ata më kanë rritur mua.

(Diskutime pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Zoti kryetar, a mundem për procedurë?

Erion Braçe – Mbledhja ndërpritet këtu.

Pa dalë deputeti në fjalë nga salla nuk...

Jorida Tabaku – Ai është anëtar i komisionit. Si mund të dalë nga salla?

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk ka mundësi që çdo javë të dalë nga një deputet jashtë...

Përparim Spahiu – Nuk më nxjerr dot jashtë ti...

(Mbledhja ndërpritet)

Erion Braçe – Rifillojmë mbledhjen.

Zonja Gjylameti...

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Duke mirëkuptuar gjithë shqetësimin që kanë kolegët e opozitës, do të doja t'i riktheheshim rendit të ditës, sepse çështjet që kemi për të diskutuar sot, bashkë me ato që diskutuam dje, nuk kanë pak ndikim, por kanë shumë, për ata që na kanë votuar, për ata që presin që nëpërmjet këtyre projektligjeve të ndryshojmë situatën ose t'u përgjigjemi më mirë kërkesave të tyre.

Projektligjet e paketës fiskale kanë një rëndësi të posaçme, sepse (duke i kthyer përgjigje edhe koleges së opozitës) ka një reflektim të kërkesave prej shumë e shumë vitesh, që i keni ngritur edhe ju, duke kthyer përgjigje dhe duke ndërmarrë disa nisma, të cilat janë në përgjigje të kërkesave të vazhdueshme të biznesit. Në mënyrë të posaçme, janë 10 mijë e 835 biznese që përfitojnë me uljen e tatim-fitimit nga 15% në 5%, nga 8 milionë në 14 milionë xhiro, duke vazhduar kështu me të gjitha ato biznese, të cilat janë të angazhuara në agroturizëm.

Unë nuk besoj se ka ndonjë nga kolegët e opozitës që nuk është i interesuar për të rritur punësimin në vend apo për të pasur situatë edhe më të favorshme për të gjithë ata që angazhohen në biznese të tilla, që janë sektorët kyç të ekonomisë shqiptare, sikundër është edhe agroturizmi.

Po të vazhdojmë kështu, duke parë edhe shifrat e turistëve që hyjnë në Shqipëri, jemi në një moment të rëndësishëm, ku duke lehtësuar sadopak dhe duke nxitur këto biznese për t'u zgjeruar më tutje, mund të ndihmojmë të gjithë ata që na kanë votuar dhe kanë bërë të mundur të jemi këtu.

Do të doja t'ju bëja thirrje të ruanit etikën, se është tërësisht absurde të përdorim fjalë fyese ndaj njëri-tjetrit. Përtej faktit që kemi miratuar një Kod Etike, mbi të gjitha kemi një kod njerëzor me njëri-tjetrin. Do të doja të ishim shumë të kujdesshëm, se kur fyejmë njëri-tjetrin këtu ballë përballë, çfarë ndodh tek ata që na dëgjojnë?

Unë nuk do të doja kurrësi të vazhdojmë dhe t'i tregojmë njëri-tjetrit përralla. Nuk besoj se ka përralla këtu, aq më pak, ndonjëri prej nesh të jetë i interesuar të nxijë vendin apo situatën.

Të gjithë e dimë, sidomos ata që janë ekonomistë, ekonomia ecën me ndjesi, konsumi ecën me ndjesi.

Duke thënë gjatë gjithë kohës se situata është e zezë, se investime nuk ka, droga, krimi, të flasim për çdo gjë dhe aspak për rendin e ditës, që është në përgjigje të kërkesave të

vazhdueshme të atyre që janë të angazhuar në këto biznese, që përfshihen në lehtësirat fiskale, që sot kemi për t'i diskutuar, mendoj se sinjalet që u çojmë njerëzve janë të këqija.

Të gjithë ata që na ndjekin duan të dëgjojnë se si ndërmarrim politika në përgjigje të kërkesave të vazhdueshme, si ndërmarrim politika për të rritur punësimin, për të rritur mirëqenien dhe jo se si fyhemi me njëri-tjetrin dhe vazhdojmë të tregojmë kush di e kush nuk di, sa marrim vesh dhe sa nuk marrim vesh, apo edhe më tutje akoma, që interesi i opozitës është interesi i vendit dhe interesi i maxhorancës nuk është interesi i vendit. Nuk besoj se jemi në të tilla...

Ndaj, do t'u kërkoja të gjithë kolegëve, qoftë atyre të krahut tim, qoftë atyre të krahut përballë, së paku, të ngrihemi në lartësinë e detyrës të gjithë bashkë dhe të diskutojmë mbi çfarë kemi. Pastaj, për çdo çështje të tjetër është në interesin e tyre, por besoj se është edhe në interesin tonë, të thërrasim ministrat dhe t'i diskutojmë, përtej faktit që ne nuk jemi një komision përgjegjës dhe me aq sa munda të ndiqja ka pasur debat goxha të gjerë e të gjatë me pyetje dhe përgjigje në komisionin përgjegjës për çështjen e teatrit.

Ndërkohë, nëse duhet të diskutojmë se çfarë ndikimi ka në pjesën financiare apo në buxhetin e shtetit ky projektligj, ta diskutojmë më pas dhe të thërrasim edhe ministrin përkatës të diskutojë këtu.

Do t'ju lutesha të gjithëve, së paku, t'i japim mundësinë njëri-tjetrit të diskutojmë për rendin e ditës. Nëse duhet të bëjmë një mbledhje tjetër për këtë çështje, le ta bëjmë, të ezaurojmë argumentet, por të mos ndodhë siç ndodhi dje, një kakofoni dhe, më vjen keq, që duhet t'i them koleges sime të opozitës se pyetjet që drejtove s'i dëgjuam as ne, jo më ministri që ishte pak më larg, sepse flitej njëkohësisht nga të gjithë.

Gjëja tjetër që kam, kryetar, është për ju. Nuk mundeni kurrësi, pavarësisht se duhen respektuar deputetë e opozitës para nesh të maxhorancës, të vazhdojmë kështu. Nëse unë kërkoj fjalën për procedurë përpara shumë kolegëve të opozitës, duhet të respektohet radha dhe duhet t'ua kishit dhënë fjalën, jo tani pas kaq shumë diskutimesh, por që në fillim. Në këtë mënyrë të ruajmë edhe barazinë e trajtimit tek të dyja palëve.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ju, për çfarë?

Jorida Tabaku – Për procedurë.

Erion Braçe – Për procedurë?

Cila është procedura, zoti Balliu?

Klevis Balliu – Të flas unë dhe do ta kuptosh procedurën.

Erion Braçe – Dakord.

Klevis Balliu – Nuk do të ma japësh fjalën?

Erion Braçe – Merre fjalën, pa asnjë lloj problemi, por ta dimë për çfarë do të flasësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti flet pa e ditur se për çfarë do të flasësh?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdoni, e keni ju fjalën.

Klevis Balliu – Shoh se kolegët e maxhorancës paskan shumë halle dhe probleme. Drejtohuni tek ai portali *shqipëriaqëduam*. Për tri minuta dhe për 10 ditë ju kthen përgjigje një ministër, pa merak!

Erion Braçe – Zoti Balliu, kjo nuk ka lidhje me procedurën.

Klevis Balliu – A ka mundësi ta mbaroj fjalën?

Kishin një shqetësim dhe unë i ktheve përgjigje si zgjidhet. Kryeministri ia thotë gjithë Shqipërisë: “Te portali, 3 minuta dhe mbaroni punë”, ju vini na e kërkonin ne. Drejtojuni direkt portalit!

Erion Braçe – Merruni me gjëra thelbësore, zoti Balliu.

Klevis Balliu – Të gjitha thelbësore janë këto, edhe kjo e portalit, se kanë shqetësime kolegët, që e kanë zgjidhjen te portali.

Erion Braçe – Ashtu, ë? Po mirë, atëherë drejtoju portalit për këtë punën e Teatrit dhe merr përgjigje për 3 minuta.

Klevis Balliu – Mos më ndërprit fare! Prit tani, ta mbaroj fjalën! Ke bërë diskutime dhe të kam dëgjuar pa të ndërprerë në çdo diskutim. Të lutem, më lër të bëj diskutimin tim, po pate mundësi!

Erion Braçe - Zoti Balliu, meqë nuk jeni pjesë e këtij komisioni, por jeni nga një komision tjetër...

Klevis Balliu – Zoti Braçe, lërinin këto filma, “je a nuk je anëtar komisioni”.

Nuk e di, a të tha njeri apo e ke nga vetja që nuk do ta mbaroj fjalën? Më lër të mbaroj fjalën! Kaq po të kërkoj. Nuk është ndonjë gjë e madhe. E di që në partinë tuaj nuk kërkohen

gjëra të tilla, por mua më lini të them këto 2-3 pika që kam, që janë shqetësime për ne, besoj edhe për disa nga kolegët e maxhorancës, po patët mundësi.

Drejtojuni portalit dhe diskutojeni, “Tri minuta,- tha ai,- dhe për 10 ditë ju vjen përgjigjja dhe juua zgjidhin. Do t’ju përgjigjet ministri përkatës”. Dakord? Tani, të mbaroj unë... Unë nuk kisha hall me qeverinë...

Erion Braçe – Zoti Balliu, patjetër që e keni ju fjalën, por do t’ju lutesha shumë të kursenit komentet për kolegët deputetë që janë në sallë!

Klevis Balliu – Nuk bëra asnjë koment për asnjë koleg...

Erion Braçe – Atëherë, mos iu drejtoni fare! Vazhdoni flisni...

Klevis Balliu - Bëra koment për shqetësimin e kolegëve dhe unë isha shumë i shqetësuar që nuk po gjejnë përgjigje...

Erion Braçe – Zoti Balliu, kjo ironia juaj është shumë therëse, por, ju lutem shumë, vazhdoni dhe merruni me thelbin!

Klevis Balliu – A do më lësh të flas?

Për çështjen që ngritën edhe kolegët e maxhorancës, se pse nuk po diskutohet rendi i ditës, arsyeja pse po ndodh kjo, se është dhe pak si *deja vu*: a kemi rreth 3 muaj që themi se nuk hapen negociatat po nuk dha Fatmir Xhafaj dorëheqjen, po nuk u fut Saimir Tahiri në burg (aty ku e meriton të rrijë), po e nxorët Mark Frrokun? Nuk u hapën negociatat. 3 muaj nuk na dëgjuat. Mos bëni të njëjtin gabim tani. Edhe çështja e Teatrit Kombëtar është e njëjta... Në fakt, ka zero lidhje me vetë teatrin. Kjo ka të bëjë me një aferë korruptive të radhës së kësaj qeverie, se nuk janë të pakta afëra korruptive.

Dua të qartësoj edhe opinionin publik. Shumë njerëz më pyetën: “Ore, për çfarë qëndroni këtu ju dhe për çfarë qëndron maxhoranca, se ne nuk po marrim vesh gjë të ky debat?” Është shumë e thjeshtë. Partia Demokratike kërkon rehabilitimin e Teatrit Kombëtar, siç është, pa bërë kulla. Nuk ka një shifër të dhënë, pavarësisht se ministria thotë se nuk kemi para, se sa do të kushtonte rehabilitimi, se mund të jetë më pak se 30 milionë euro.

Gjithashtu, dëgjova nga ky komision se ju nuk dini as se sa metra katrorë është, as sa para do të hidhen, as sa lekë do të marrë ky zotëria i kompanisë Fusha sh.p.k. Keni shumë të drejtë, nuk e dini ju këtë, se nuk keni si ta dini, sepse ka 0 transparencë. Këtu çdo biznes, çdo marrëveshje, bëhet me kodin e omertës, sepse kjo është simbolika e kësaj qeverie dhe këtë nuk e them unë, por këtë e thotë një seri faktesh, siç është edhe inkriminimi i institucioneve të shtetit.

Kjo qeveri punon me ligjin e omertas, me kodin e omertas. E kam thënë edhe më përpara, ka shumë deputetë këtu që nuk ndodhen në tavolinat e “Rilindjes”, por duke mos folur, ju bëheni pjesë e atyre tavolinave.

Por çfarë ka për të kuptuar këtu?! U dashka të prishet Teatri Kombëtar, që t’u bëkan këto 6 kulla?! Nuk ka lidhje ajo që “jeni nga qyteti apo jeni nga fshati”, se edhe unë jam nga Mokra, por Mokra ka monumente kulture dhe i them kujtdo, edhe zotit Xhakolli, që nuk e keni, edhe Blerinën e keni nga Mokra...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E pra, ka monumente kulture në çdo fshat të Shqipërisë. Ka monumente kulture në çdo qytet të Shqipërisë dhe cilido njeri që do kulturën revoltohet nga shembja e këtij Teatri, që nuk kishte absolutisht asnjë arsye për t’u shkatërruar. E vetmja arsye ishte për të vjedhur edhe disa para të tjera, se i keni shpenzuar paratë.

Ju thoni se nuk keni para për të ndërtuar Teatrin, por a do të keni ju para për ta mbajtur atë teatër që do të bëni? Apo për të parë teatër do ta vendosni biletën 200 euro?

Si do ta mbani atë teatër kur nuk paskeni para për ta ndërtuar?! Apo do ta mbajë kompania Fusha sh.p.k.?

Pyetja tjetër, si do t’ia bëjmë me Bibliotekën Kombëtare, se sheshi i Erion Veliajt të Griseldës e shkatërroi Teatrin Kombëtar? Do t’i fusni ndonjë kullë edhe Bibliotekës, se e ai shesh e përmbysi? Të bëjmë edhe dy kulla të tjera aty?

Po pse, çdo gjë me kulla do ta zgjidhni ju? Te stadiumi vutë kullë, tek Tetari do të bëni kullë, te Biblioteka Kombëtare do të bëni kullë dhe doni të diskutoni këtu për rendin e ditës!

I vetmi rend dite që duhet të diskutohet këtu është si duhet ta zhdukim këtë kolerë që e ka zënë Shqipërinë, që e ka emrin Edi Rama. Se Edi Rama nuk ka absolutisht asnjë faj, se nuk ka asnjëri këtu, përfshirë edhe ju të maxhorancës, që nuk e ka njohur se kush ishte Edi Rama. Të gjithë ju keni përgjegjësi që e keni sjellë këtë këtu, ju, analistët, gazetarët, që e mbështesnit deri dje.

Bëri një pyetje kolegu këtu: “Si erdhi Kryeministri?” Është pyetje që do përgjigje, se të gjithë këta gazetarë e analistë, që flisnin kundër qeverive të tjera, që flisnin kundër qeverisë “Berisha”, për të sjellë këtë individ, këtë kolerë, që inkriminon institucionet e shtetit, këtë njeri që sot na ka bërë...

Kemi kamerierët më të shkolluar në Shqipëri, sepse nuk gjejnë dot një vend pune. Janë të gjithë me diploma juridiku dhe mbesin kamerierë, kurse ata që janë në shkolla detyrohen të lënë shkollën për të shkuar në punë, se nuk përballojnë dot tarifat që vendosi ky. Këtu e solli ky vendin, tek kjo batërdisht na çoi.

Sot doni të na tregoni se ne paskemi hallin e Toyota-ve. E paskemi ne hallinë e Toyota-ve, apo e ka Taulanti? Apo e ka Rama? Apo e ka Olsi Rama?

S'keni thënë një fjalë për dosjen e "Xibrakës".

S'keni thënë një fjalë për Saimir Tahirin. Njësoj siç po mbronin këtë aferë korruptive, deri dje mbronin Saimir Tahirin, more zotërinj!

Po si nuk u çua një deputet i maxhorancës të thotë: "Ore, po pse duhet ta marr këtë njeri këtu? Pse duhet ta mbaj unë këtë Saimir Tahirin këtu, kur ky paska kushërinj që merren me drogë? Pse më duhet mua ky Fatmir Xhafaj, se ky paska vëllain me drogë?"

Si nuk u ngrit të fliste një person dhe pastaj doni të thonin që s'paskeni përgjegjësi ju, sepse disa prej jush nuk janë përfshirë në aferat korruptive, se nuk paskeni qenë ju tek ajo tavolinë? Ju keni përgjegjësi, sepse po e mbani gjallë këtë qeveri dhe këtë kolerë që e ka zënë Shqipërinë.

Përgjegjësia që kjo qeveri dhe Edi Rama do të marrë do të jetë e barabartë me dhimbjen që u shkaktoi nënave shqiptare, të cilat sot i kanë të gjithë fëmijët në kurbet. Janë larguar nga vendi 500 000 shqiptarë, kurse ju vini bëni humor këtu. Thotë tjetri ka bërë gabim që është rritur ai.

Doni të diskutoni këtu për etikë? Pse nuk shikoni etikën e Kryeministrit, i cili shan me fjalën të ndyra qytetarët shqiptarë? Na shani ne, sepse jemi mësuar me ju, por me qytetarët shqiptarë, të cilët nuk paguajnë dot as faturën e energjisë, sepse i keni lënë pa punë, çfarë keni.

Të gjithë rininë e Shqipërisë e drejtuan drejt plantacioneve të kanabisit. Për çfarë rendi do të flasim? Doni të miratojmë një ligj tjetër, që nuk do të respektohet? Nuk ka ligj kundër drogës? A e respekton njeri ligjin kundër drogës, të cilën sot e gjen në çdo cep të Shqipërisë? Kemi ligj kundër korrupsionit, por ai gjendet në çdo cep të Shqipërisë, duke filluar me çështjen e Teatrit Kombëtar.

Janë pikërisht këto arsye pse sot qytetarët shqiptarë jetojnë në varfëri, pse Shqipërisë nuk iu hapen negociatat: aferat korruptive, implikimi i kësaj qeverie me krimin e organizuar.

Dëmin që ju i shkaktuat Teatrit ju ia shkaktoni edhe popullit shqiptar. Historia e një vendi është identiteti i popullit të atij vendi dhe vetë vendit. Unë e kuptoj që gjenetikisht kjo parti vjen nga Partia Komuniste, që gjenetikisht është e lidhur me simbiozat e Enver Hoxhës, që ka veset e komunizmit, të cilave nuk u ndahet dot dhe disa vese të tjera ia ka shkruar ky i gjati, që keni sot për kryetar.

Si do të hapen negociatat kur drejtuesi i procesit të integritetit të Shqipërisë është Ditmir Bushati, djali i Sulë Bushatit, sekretarit të komitetit të partisë së rrethit Shkodër, i cili ka plot shtatë faqe me internime në Shkodër? Ky do të na integrojë ne? Apo djali i Kristaq Ramës? Apo ambasadorja e Shqipërisë në Holandë, e cila është mbesa e sekretarit personal të Enver Hoxhës? Vetëm këlyshët e Bllokut mund ta bëjnë integrimin e Shqipërisë në Europë? Nuk kemi të tjerë ne? Nuk ka në Partinë Socialiste njerëz të financave, akademikë? Ky i largoi Arben Malajn, Blushin, i cili me gjithë të zezat që ka, është shkrimtar fundja. Nuk merret dot vesh me atë ky, sepse ky është mësuar me drogaxhinj, narkotrafikantë, me Saimirin.

Ironinë, zoti kryetar, me të cilën qeshni herë pas here mbajeni për vete dhe bëjeni me ndonjë vend tjetër, jo këtu. Po drejtohen komisionet nga xhepistë. Shko nënqesh diku tjetër!

Erion Braçe – Ai i Gërdecit ta tha?

Klevis Balliu – Mbylle mikrofonin! Kur flas unë, mbylle mikrofonin!

Erion Braçe – Çfarë the?

Klevis Balliu – Mbylle mikrofonin kur flas unë!

Erion Braçe - Zoti Balliu, nuk ke të drejtë të flasësh më.

Klevis Balliu – Kur flas unë, mbaj qetësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbylle mikrofonin, sepse nuk e kam mbaruar fjalën. Dëgjova të gjitha mashtrimet e tua të radhës, prandaj tani mbylleti mikrofonin të flas unë.

Erion Braçe – Neni 31 i Rregullores së Kuvendit ...

Klevis Balliu – Mbylle mikrofonin!

Erion Braçe – O djalë, dil përjashta. Hajdut! Ti dhe familja jote keni vrarë 26 vetë në Gërdec.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ty të tregoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne të dy do ta zgjidhim në gjykatë.

Merr edhe babain dhe të vij ta provoj atje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

26 të vrarë atje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 31 i Rregullores së Kuvendit ...

Klevis Balliu – Mbylle mikrofonin, xhepist! Mbylle mikrofonin!

Erion Braçe – A ke fytyrë ti?

Klevis Balliu – Flet ti për fytyrë?

Erion Braçe – Ti jeton në një kullë 22 kate e lartë dhe vjen flet për kulla?

Klevis Balliu – Te cila kullë jetoj unë? Hajde ta tregoj unë ku banoj. Te kulla e atij që të mbante motrën dhe dhëndrin ty në punë? Te kulla e tij? Nuk banoj tek ajo kullë unë? Mbylle mikrofonin që të vazhdoj fjalën unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Harroje ta marrësh më fjalën.

Klevis Balliu – Mos fol fare.

Erion Braçe – Ti nuk shkel më në këtë komision. Ky komision nuk bën më mbledhje nëse do të jesh ti këtu brenda.

Klevis Balliu – Kurrë nuk ka për të bërë mbledhje.

Erion Braçe – Neni 31: Ndryshimi i rendit të ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu – Pa hyrë unë nuk ...

Erion Braçe - Nuk e vendos ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 31: Ndryshimi i rendit të ditës. “Kuvendi ose komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës. Kuvendi mund të vendosë në çdo kohë që komisionet e përhershme të kenë në rendin e ditës së tyre një ose më shumë çështje në përputhje me programin e punës dhe me kalendarin e punimeve të Kuvendit”. Prej një orë e gjysmë këtu po diskutohen çështje që nuk janë fare në rendin e ditës, kështu që kalojmë te rendi i ditës.

Fjalën e ka zëvendësministri për prezantimin e projektligjit.

Zoti zëvendësministër, hapeni mikrofonin dhe vazhdoni me prezantimin e projektligjit “Për taksat vendore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Afroje mikrofonin, zoti zëvendësministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti zëvendësministër, vazhdoni me fjalën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu – Të mbaroj fjalën unë dhe pastaj ...

Erion Braçe – Ti nuk e merr më fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush të pyet ty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa u bërë ti ministër ...

(Zëvendësministri nuk dëgjohej kur flet)

Klevis Balliu – Këtu është e rëndësishme të diskutohen çështjet dhe aferat korruptive të kësaj qeverie, e cila sot është e kalbur në drogë dhe krim.

Ju keni për detyrë t’u përgjigjeni qytetarëve shqiptarë pse është i domosdoshëm shkatërrimi i Teatrit dhe pse duhet ta ndërtojë pikërisht kompania Fusha? Pse nuk hapni konkurs për çështjen e Teatrit, siç bëtë me rastin e Xhamisë? Pse nuk hapni konkurs, por e caktuat që do të jetë kompania Fusha? Kush do të përgjigjet? Është e domosdoshme, sepse pronari i kompanisë Fusha është djali i xhaxhait të prokurorit Fusha, i cili shpëtoi Orionën dhe Griseldin. Duhet ta fitojë kompania Fusha, sepse duhen paguar paratë për mbrojtjen që iu dha Erion Veliajt.

Sot vini këtu dhe na tregoni moralin. Pse nuk e shikoni moralin të Kryeministri juaj, i cili shan me fjalë të ndyra qytetarët shqiptarë? Ky tjetri këtu tregon gjyqet. Cilat gjyqe do tregosh ti? Gjyqet e kujt? 198 gjyqe kemi bërë me ju dhe ju nuk keni fituar asnjë prej tyre.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Zoti Bushati ...

(Ervin Bushati nuk dëgjohej kur flet)

Klevis Balliu - Së fundi, edhe kolegët e Partisë Socialiste duhet të dinë se kë kanë në krahë, se me kë flenë dhe të mos zgjohen si në rastin e Mark Frrokut, kur thanë që nuk e dinin

se ishte me probleme me të gjithë, si në rastin e Elvis Roshit për të cilin thanë që nuk e dinin se ishte marrë me prostitucion, si në rastin e Saimir Tahirit, për të cilin thanë se nuk e dinin që kishte kushërinj narkotrafikantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbaroj fjalën unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Prezantimi nga ministri për Financat dhe Ekonominë i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”
3. Relativim
4. Pyetje përgjigje
5. Diskutimi në parim
6. Projektligji “Për ratifikimin e korigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Reme Lala, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Agron Shehaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike

Mungon:

Dashamir Shehi

Të ftuar:

Erjon Luci – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci (Bako) – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erjon Braçe - Kalojmë tek shqyrtimi i marrëveshjes me BERZH. Zoti zëvendësministër keni fjalën.

(Erjon Luçi nuk dëgjohet kur flet)

Klevis Balliu- I nderuar zotëri, a ka mundësi të mbaroj fjalën unë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ju do të vazhdoni të bëni këto lojëra, sepse nuk doni të kuptohet çfarë ka ndodhur, ajo është e drejta juaj dhe unë nuk e ndaloj dot, por paçavure të tilla nuk do i ndihmojnë qytetarët, siç nuk ndihmojnë as fasadat e këtij zotërisë, i cili thotë shkruani në portal, sepse ju zgjidhen hallet.

Erion Braçe – Fjalën e ka zoti Bushati si relator i komisionit për këtë çështje.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Siç e shikoni nga tabelat, ndryshimi që propozohet në projektligj ka të bëjë ... dhe të kështit të fundit të huas, me qëllim që të korrigjohet një lapsus në ndarjen e kësaj huaje. Pra, për të ruajtur të pandryshuar totalin e huasë prej 100 milionë dollarë amerikanë, si dhe afatin e fundit të pagesës së huasë, saktësohet se çdo datë 15 mars dhe 15 shtator do të vijojë të paguajë ...

Klevis Balliu - Zoti kryetar, pyetët më parë sa metra katrorë janë. Janë fiks këto. Sot keni 1700 metra katrorë pronë private dhe ...

Erion Braçe – Ka pyetje për marrëveshjen?

Klevis Balliu – Kam unë pyetje.

Erion Braçe - Ka ndonjë diskutim për marrëveshjen me BERZH-in?

Klevis Balliu – Zotëri, ti mund të bësh filmin “ka apo jo diskutime”, por dëgjo ato që janë për t’u thënë. Të flasë opozita dhe pastaj merrni ju fjalën.

Erion Braçe – Kalojmë në votimin në parim të Projektligjit “Për ratifikimin e korrigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Klevis Balliu - Prisni të mbaroj fjalën. Çfarë frike keni? Nuk flisni dot për kompaninë Fusha? Jua ka lidhur litarin ai? Nuk flet dot për ministrin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe- Kush është kundër? Pro? Abstenim? Miratohet.

Neni 1 kundër? Pro? Abstenim? Miratohet.

Neni 2 kundër? Pro? Abstenim? Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi Kush është kundër? Pro? Abstenim? Miratohet.

Klevis Balliu - Bravo, Enver Hoxha! Kundër s'ka, abstenim s'ka. Ju takon fiks partia që keni, partia e Sulë Bushatit, zyrtarit të degës, i cili nuk la njeri në Shkodër pa internuar.

Ju mund t'i vazhdoni këto lojëra dhe shëmtira, por duhet të dini që në një moment do të mbani përgjegjësi, prandaj nuk e vë firmën ministri i financave. Prandaj nuk e vë firmën Erion Veliaj, por ia kalojnë nënkryetarit.

Erion Braçe - Mbyllet mbledhja

Klevis Balliu - Bravo! Mbathjani përsëri!

MBYLLET MBLEDHJA